

AKTI I THEMELIMIT



DHE

STATUTI I

SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUEIZUAR

" ELTONA " ERSEKË.

AKTI I THEMELIMIT

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "ELTONA" ERSEKË.

Unë Ali Aliu i biri i Fetahut lindur më 1946 në Ersekë dhe banues në Ersekë në Rrugën e "Rehovës" Pall.20 sh.1 ap.6, sot më datë 10.8.1994, themelok shoqërinë me përgjegjësi të kufizuar me emrin "ELTONA" Ersekë me këto kushte;

Neni 1

Shoqërija me përgjegjësi të kufizuar "Eltona" Ersekë është person juridikmë vehte dhe krijohet për të zhvilluar veprimtari privat sipas objektit të saj që përcaktohet me saktësi në statutin e saj.

Neni 2

Shoqërija qëndrën e veprimtarisë do ta ketë në Rrethin e Kolonjës në Rrugën e "Rehovës" Pall.20 sh.1 ap;6 dhe do të veprojë në të gjithë Republikën.

Neni 3

Kapitali bazë i kësaj shoqërije fillimisht do të jetë 100.000 lekë, pa përfshirë këtu vlerën e paisjeve dhe makinerive. Me zhvillimin e shoqërisë ky kapital mund të shtohet apo edhe të pakësohet në përputhje me mbarëvajtjen e punës.

Neni 4

Kjo shoqëri krijohet vetëm prej meje si ortak i vetëm dhe vetë do të jem edhe administratori i saj. Me zhvillimin e aktivitetit mund të bëj edhe ndryshime, të cilat do ti pasqyroj në dokumenta të vecanta.

Neni 5

Sipas legjislacionit në fuqi me zhvillimin e aktivitetit do të punësoj edhe punonjës të tjerë, sipas mundësive të punës.

Neni 6

Këtë shoqëri e krijova për një afat kohe prej 16 vjetësh, me të drejtë përtëritje me kalimin e këtij afati.

Neni 7

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve që mund të lindin, do të bëhet sipas legjislacionit në fuqi në gjykatën e Ersekës.

Neni 8

Dispozita më të hollësishme për këtë shoqëri përcaktohen në statutin e saj.

THEMELUESI Ali Aliu



S T A T U T I

I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR "ELTONA" ERSEKË.

KREU I

DISPOZITA TË PËRGJITHËSHME

Neni 1

Kjo shoqëri është krijuar në përputhje me Ligjin Nr.7638 datë 9.XI.1992 " Mbi shoqëritë tregëtare" dhe është person juridik më vehte.

Të drejtat e personit juridik kjo shoqëri i fiton nga data e dhënies së vendimit përkatës nga Organet Gjyqsore.

Neni 2

Kjo shoqëri është themeluar nga ortakut i vetëm Ali Aliu i biri i Fetahut, lindur më 1946 në Ersekë dhe banues po aty në Rrugën e "Rehovës" Pall.20 sh.1 ap.6.

Neni 3

Kjo shoqëri e ushtron aktivitetin e saj tregëtar në përputhje me "Kodin Tregëtar" dhe legjislacionin Shqipëtar si dhe me dispozitat e paraqitura në dokumentat e krijimit të saj.

Neni 4

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "ELTONA" Ersekë, krijohet për të ushtruar veprimtari private në këto drejtime;

- Projektimi dhe ndërtimi i objekteve civile të cdo lloji, Industriale, turistike, bujqësore etjera, si dhe instalimet e tyre.
- Punime restaurimi të cdo lloji.
- Punime ujësjellësi dhe kanalizime.
- Punime dheu, buraturë betoni, betoarme të zakonëshme, punime shëmbjesh etjera.

-Prodhim material ndërtimi në përgjithësi, prodhim lënde drusore dhe aktivitet ndihmës mekanik dhe transport në të gjithë Republikën dhe jashtë saj si dhe tregëtimi i këtyre materjaleve si të vendit dhe të importit.

Neni 5

Detyrimet që lindin gjatë zhvillimit të këtij aktiviteti pronari u përgjigjet me mjetet e veta.



[Handwritten signature]

KREU II

KUSHTET EKONOMIKE

Neni 6

Veprimtarija e kësaj shoqërije zhvillohet në bazë të leverdisë ekonomike dhe pasqyrohet në bilancet e saj periodikë.

Neni 7

Për të bërë të mundur zhvillimin e këtij aktiviteti privat, vihet një kapital bazë prej 100.000 lekë, përveç vlerën e makinerive e paisjeve, që përbën burimin fillestar të krijimit të fondit themelor dhe të mjeteve të xhirros.

Ky kapital mund të shtohet apo edhe të pakësohet sipas vendimit që merr pronari i saj.

Neni 8

Kur pushon aktiviteti pasi shlyhen të gjitha detyrimet ligjore pjesa e mbetur e kapitalit mbetet pronë e pronarit të saj.

Neni 9

Shoqëria gëzon të drejtën e mbrojtjes së pasurive të veta në përputhje me legjislacionin në fuqi.

KREU III

ADMINISTRIMI

Neni 10

Pronari i shoqërisë e administron vetë, të gjithë zhvillimin e veprimtarisë private, sipas ligjeve në fuqi, duke qënë dhe administrator i saj. Ai ka të drejtë të punësojë edhe persona të tjerë që ai i shikon të arsyeshëm për ushtrimin e kësaj veprimtarije, sipas të gjitha normave ligjore "Për mardhëniet e Punës".

Pronari ka të drejtë të ndryshojë, të shtojë apo pakësojë veprimtarinë private sipas interesit të tij.

KREU IV

PUSHIMI I AKTIVITETIT

Neni 11

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar "ELTONA " Ersekë e



pushon aktivitetin e saj me plotësimin e afatit prej 16 vjetësh.

Neni 12

Kur pushon aktiviteti të gjitha pasuritë që janë vënë në dispozicion, mbeten pronë e pronarit të saj, mbasi të jenë bërë të gjitha likuidimet dhe pagesat për të tretët.

Neni 13

Kjo shoqëri krijohet për një afat kohe prej 16 vjetësh me të drejtë përsëritje me kalimin e këtij afati.

Neni 14

Selia e kësaj shoqërije do të jetë në Ersekë, në Rrugën e "Rehovës" Pall.20 sh.1 ap.6.

Ky statut pasi u lexua dhe u gjet në rregull, firmoset prej themeluesit të shoqërisë dhe administratori i saj zoti Ali Aliu.

Aliu

Tiranë më 10.8.1994

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

NOTERIA

Nr. 71 Rep.

Nr. 34 Kol.

V E R T E T I M

Sot më 10.8.1994 u paraqit personalisht para meje Aliu noter në këtë qytet zoti Ali Aliu me letërnjoftimin personal me Nr.AZ.035221, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar i cili më deklaroi se është dakord me aktin e themelimit dhe statutin dhe firmosi para meje dhe unë noter i veërtetoj rregullisht. - - - - -

Noter

Aliu
Aliu

